



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 49, datë 28.12.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT ONE
TELECOMMUNICATIONS, NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 10
STACIONE BAZË TË EMËRTUARA: 1. SHKODRA SE 1671; 2. SKURAJ 1712; 3.
STADIUMI NEW 0222; 4. ELBASANI SOUTH 1653; 5. SHIJAKU CITY 1450; 6.
THUMANA NEW 1467; 7. VLORA ÇOLE 1591; 8. RADHIMA SOUTH 1661, ME
VENDNDODHJE NË BASHKITË SHKODËR, KURBIN, TIRANË, ELBASAN, SHIJAK,
KRUIË DHE VLORË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “One Telecommunications” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit One Telecommunications, nëpërmjet shtimit të antenave për 8 stacione bazë të emërtuara: 1. Shkodra SE 1671; 2. Skuraj 1712; 3. Stadiumi New 0222; 4. Elbasani South 1653; 5. Shijaku City 1450; 6. Thumana New 1467; 7. Vlora Çole 1591; 8. Radhima South 1661;”, me vendndodhje në Bashkitë Shkodër, Kurbin, Tiranë, Elbasan, Shijak, Kruië dhe Vlorë, me zhvillues shoqërinë “One Telecommunications” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 10 stacioneve bazë, vetëm pas:
 - a. Për stacionin “Shkodra SE 1671”:
 - lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër.



- b. Për stacionin **“Skuraj 1712”**:
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kurbin.
- c. Për stacionin **“Stadiumi New 0222”**:
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
- d. Për stacionin **“Elbasani South 1653”**:
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Elbasan.
- e. Për stacionin **“Shijaku City 1450”**:
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shijak.
- f. Për stacionin **“Thumana New 1467”**:
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Krujë.
- g. Për stacionin **“Vlora Çole 1591”**:
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
- h. Për stacionin **“Radhima South 1661”**:
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
 - miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU




ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

